

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E KULTURËS ME OBJEKT
“MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”,
PËR PERIUDHËN 01.01.2014 - 31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Ministrinë e Kulturës, me objekt “Mbi auditimin financiar mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” për periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 62, datë 30.06.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 78/19, datë 06.07.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Mirela Kumbaro, Ministër i Kulturës, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

AI- Për projektet në kulturë e trashëgimi:

-Financimi i projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore të propozuara nga Ministria e Kulturës, janë bërë pa u paraqitur më parë projektidetë konkrete nga drejtoritë përkatëse për artin-kulturën dhe trashëgiminë si rrjedhojë llogaritja e fondit limit për financimin e projekteve nuk është i argumentuar.

-Preventivat e paraqitur nga aplikantët për projektet e hartuara nga Ministria e Kulturës si dhe për çdo thirrje nuk i është bërë analizë kostoje nga kolegjiomet si pasojë nuk ka pasur opionencë ekonomike për çmimet e ofruara nga subjekte të ndryshme.

-Për kontratat e lidhura për projektet e financuara nga Ministria e Kulturës nuk ka një bazë të dhënash (*data base*) për kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto kontrata.

-janë likuiduar subjekte përfituese të projekteve pa justifikuar zërat e financuara me dokumentet vërtetues sipas kontratave të lidhura në kundërshtim UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë e sektorit publik”.

-Procedurat dhe nënshkrimi i kontratës me Njësinë e Menaxhimit të Projektit “*Institutin e Kërkimeve Urbane*” për llogari të projektit “ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” nominimi dhe ftesa e pjesëmarrësve në negociim janë kryer në shkëlje me rregulloret e fondeve IPA si dhe marrëveshjen e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar, duke i dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë “*Institutin të Kërkimeve Urbane*” menaxhimin e a fondeve të cilat Ministria duhet ti menaxhonte me efektivitet e transparencë.

-Shumica e akteve administrative të nxjerra nga Kolegjiumi apo Ministri, bëhen brenda limiti kohor shumë të shkurtër (1 ditë) duke lënë shteg që marrja e vendimeve të jetë fiktive dhe për pasojë dhe funksionimi i Kolegjiumeve të jetë fiktiv.

-Në rastet kur subjektet që paraqesin projekte për financim nga ana e MK, janë persona juridikë apo fizikë të huaj, kontratat e lidhura me ta nuk janë të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe, sipas parimeve Kushtetuese, duke u protokolluar në këtë mënyrë në kundërshtim me ligjin “Për arkivat”. Kjo ka sjellë si pasojë, që të ketë mospërputhje mes përkthimit jo zyrtar dhe origjinalit të kontratës në gjuhë të huaj me ndikim negativ në likuidimin e shpenzimeve.

-Dosjet për financimin e projekteve kanë të protokolluar vetëm aktet administrative (procesverbalet) të prodhuara nga Kolegjiumi dhe nuk kanë të bashkangjitur projektpropozimet e paraqitura nga subjektet si dhe dokumentacionin e kërkuar në thirrjen për aplikim, duke sjellë si pasojë që gjykimi i auditimit për këto dosje të jetë jo i plotë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 32-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

-Në asnjë rast financimi i projekteve të hartuara nga Ministria e Kulturës (*projekte të brendshme*) të mos bëhet pa pasur projektide, projektpropozime të cilat çojnë në llogaritjen e argumentuar të vlerës së financimit në të gjitha nën zërat sipas preventivit në zbatim të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, neni 27/1 “*Për Artin dhe Kulturën*” i ndryshuar dhe VKM nr. 709, datë 24.10.2012 “*Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore*”.

-Në Rregulloren e funksionimit të Kolegjiumit që miratohet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën sipas ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “*Për Artin dhe Kulturën*” i ndryshuar, neni 27/2, të përcaktohen afatet për nxjerrjen e akteve administrative nga Kolegjiumi, në mënyrë që të evitohen procedurat fiktive të vendimmarrjes.

-Të merren masa për kontabilizimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e lidhura për projektet e financuara nga kjo ministri, të evidentohet gjithashtu dhe vlera e paradhënies në masën 60% të vlerës së kontratës, që përbën dhe fazën e parë të financimit të projekteve.

-Protokollimi i kontratave në gjuhë të huaj të bëhet pasi të jetë bërë më parë përkthimi zyrtar i tyre, referuar ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për arkivat*”.

-Të merren masa për protokollimin e dosjeve të projektit duke konsideruar si pjesë të protokollit, të gjithë praktikën e vlerësimit të projektpropozimeve të paraqitur nga subjektet që kërkojnë financimin e projekteve.

Në vijimësi

A2- Për restaurimet e objekteve “Monument Kulture”:

-Procedurat e restaurimit për objektet “*Muzeut Historik Kombëtar*”, “*Pallati i Kongreseve*”, “*Fasadave të Objekteve në sheshin “Nënë Tereza”* janë kryer sipas ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” dhe forma e procedurës së tenderave me “*Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit*” kur duhej të kryeshin sipas ligjit “*Për trashëgiminë Kulturore*” pasi objektet e mësipërme janë “*Monumente Kulture*”.

-Subjektet kontraktuese, për restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin e monumenteve të kulturës nuk janë subjekteve të licencuara për këtë qëllim dhe përzgjedhja e tyre nuk është bërë nëpërmjet “*konkurrimit publik*” por “*procedurës së prokurimit publik*”.

-Në situacionet përfundimtare të restaurimeve janë situacionuar zëra dhe sasi punimesh të pa miratuara, më tepër se sasi të preventivave të miratuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

Sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 9048, dt. 7.4.2003 “*Për trashëgiminë Kulturore*” me ndryshimet, neni 17, pika 1, “*Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjektet e licencuara për këtë qëllim*”, VKM nr. 216, datë 18.4.2007 “*për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Procedura e rikonstruksioneve, restaurimeve të monumenteve të kulturës të kryhet “*nëpërmjet konkurrimit publik*” nga institucionet e autorizuara për këtë qëllim dhe jo nëpërmjet “*procedurës së prokurimit publik*” kjo sipas VKM nr. 216, datë 18.4.2007 “*Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës*”.

Në vijimësi

Në pasqyrat financiare, formatin 6 kolona 2 “*blerje e krijuar me pagesë*” janë pasqyruar shtesat e aktiveve, 521,710 lekë për “*Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara*” në zërin “*studime dhe kërkime*” në analizë “*Rikonstruksioni i pallatit të kongreseve*”, vlera e të cilit

nuk i është shtuar investimit të kryer të përfunduar (*trajtuar më hollësisht në faqet 21-23 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Vlera e Studimet e projektimet të paraqitura në pasqyrat financiare zërin 230 “*Studime e projekte*” të “*Aktivet e Qëndrueshme të pa Trupëzuar*” me përfundimin e investimit për të cilin ato janë hartuar duhet të kalojnë në vlerën e objektit, duke u pasqyruar në rritjen e zërave përkatës të “*Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara*”.

Në vijimësi

-Në likuidimit e kryera për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla të realizuara gjatë vitit 2014 në të gjitha rastet mungonin kërkesat nga sektorët, drejtoritë mbi nevojat për mallrat e shërbime dhe në disa raste mungonin proces verbalet e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 23-32 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Nga strukturat menaxhere të institucionit (*nëpunësi i parë autorizues dhe nëpunësi zbatues*), përdorimi i fondeve buxhetore të bëhet në kushtet e një etike menaxhuese të domosdoshme për kushtet financiare të buxhetit të shtetit, duke e bërë sa më konkret shpenzimin e kryer.

Në vijimësi

-Për vitin 2014 nga Ministria e Kulturës, nuk është kryer inventarizimi i aktiveve të këtij institucioni dhe nga ana e nëpunësit zbatues dhe Sektorit të Financës, nuk është hartuar lista e aktiveve për inventarizim e aktiveve të institucionit, në bazë të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë, listë kjo që duhej t’i paraqitej titullarit të ministrisë, i cili krijon komisionin e posaçëm për kryerjen e inventarizimit sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 23-32 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Nga ana e nëpunësit zbatues dhe sektori i Financës, të hartohet lista e aktiveve për inventarizim, në bazë të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë për vitet 2014, listë kjo që duhej t’i paraqitet titullarit të ministrisë, i cili krijon komisionin e posaçëm për kryerjen e inventarizimit.

Në vijimësi

-Nga Sekretari i Përgjithshëm, në cilësinë e kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), nuk është ngritur grupi i punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Ministrinë e Kulturës për periudhat për viti 2014, sipas ligjit nr. 10269 / 2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 32-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), të ngihet grupi i punës për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të Ministrinë së Kulturës i cili të dokumentojë proceset kryesore të punës me anë të gjurmës së auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe të sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, kjo sipas ligjit nr. 10269/2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”

Në vijimësi

Gjetje nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme dërguar me shkresën nr. 714/13, dt. 31.12.2013.

Nga KLSH shkresën nr. 714/13, datë 31.12.2013, janë rekomanduar 15 masa shpërblim dëmi me vlerën **9,146,133** lekë të cilat nga auditimi rezultojnë se nuk janë zbatuar pasi nuk ka dalë urdhri për ndalesat, nuk janë kontabilizuar si detyrime dhe nuk ka filluar arkëtimi. Mban përgjegjësi Ministri i Kulturës znj. ... dhe Sekretari i Përgjithshëm znj. E.K. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 11-21 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, duke ndjekur të gjitha hapat ligjorë (administrativë, gjyqësorë e përmbardimore) në vlerën **9,146,133** lekë si më poshtë:

1-Nga shoqëria sipërmarrëse “V”, në vlerën 2,857,282 lekë, sa përfituar padrejtësisht në objektin “*Ndërtim i monumentit të 100 vjetorit të pavarësisë*”.

2-Nga ish Sekretari i Përgjithshëm M.M., në vlerën 420,280 lekë, sa likuiduar pa dokumente justifikuese shoqërinë “A” sh.p.k. për “*Veshjen e 15 autobusëve të linjave urbane me logon 100 vjet pavarësi*”.

3-Nga subjekti privat “E s” për sa përfituar më tepër, respektivisht 20,000 lekë në projektin “*1 Qershori, dita e fëmijëve*” dhe 55,000 lekë në projektin “*Mbi dimensionin fetar të dialogut ndërkulturor të zhvilluar në periudhën 3 dhe 4 shtator 2012*”, në kundërshtim me ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*” i ndryshuar, Kreu V “*Administrimi dhe procedurat*” neni 36 “*faturat*”.

4-Nga subjekti privat “A” në vlerën 84,000 lekë, për sa përfituar më tepër, në kundërshtim me nr. 10296, datë 08.07.2010 neni 4.

5-Nga subjekti privat “QK” Vlorë, në vlerën 20,000 lekë sa përfituar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*” i ndryshuar, Kreu V “*Administrimi dhe procedurat*” neni 36 “*faturat*”, për realizimin e projektit kulturor “*Aulona Fest 2012*” për çeljen e sezonit turistik 2012 në Vlorë.

6-Nga 9 këngëtarët në projektin artistik “*Shqipëria pa viza*”, në vlerën 295,966 lekë për tatimin në burim të pa mbajtur në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”.

7-Nga subjekti privat “Yl”, në vlerën 340,000 lekë, sa përfituar padrejtësisht në realizimin e projektit kulturor “*Simpoziumi i II për muzikën tradicionale*”.

8-Nga subjekti privat “G.K. (JP)”, në vlerën 247,214 lekë sa përfituar në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 10352, date 18.11.2010 pika 2, për në realizimin e projektit kulturor Takimin e Këshillit të Evropës 2012, me objekt “*Mbi dimensionin fetar të dialogut ndërkulturor*”.

9-Nga shoqëria e “...”, në vlerën 245,000 lekë sa përfituar padrejtësisht në projektin kulturor të bukinistëve me rastin e “*100 Vjetorit të pavarësisë*”.

10-Nga subjekti privat “Es”, në vlerën 186,667 lekë sa përfituar në projektin artistik “*për inaugurimin e monumenteve me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë*”, në kundërshtim me ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*” i ndryshuar, Kreu V “*Administrimi dhe procedurat*” neni 36 “*faturat*”.

11-Nga personi privat “A A”, në vlerën 1,502,514 lekë sa përfituar padrejtësisht në projektin artistik “*8 Dhjetori dita e rinisë*”.

12-Nga shoqëria “M”, në vlerën 583,200 lekë sa përfituar padrejtësisht në projektin artistik “100 vjet muzikë”.

13-Nga shoqëria “VA”, në vlerën 1,720,000 lekë sa përfituar pa dokumente justifikuese rimbursimin e shpenzimeve të kryera në projektin artistik “Karnavalet e Shkodrës”.

14-Nga punonjësit e QKKF në vlerën 535,500 lekë sa përfituar në “Festivalet 49 dhe 50 për Fëmijë”, në kundërshtim me ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, neni 5, 7 dhe 9.

15-Nga punonjësit S.J. për 11,170 lekë, A.S. për 11,170 lekë dhe F.K për 11,170 lekë, për likuidimin e faturave pritje-përcjellje mbi kufirin e lejuar.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

B1- Për restaurimet e objekteve “Monument Kulture”:

1-Nga auditimi i zbatimit të “*Punime rehabilituese Pallatit të Kongreseve*”, krahasimi i zërave të punimeve të miratuara sipas procesverbaleve me tabelat përfundimtare (*nuk ka të hartuar një preventiv përfundimtar me të gjitha ndryshimet për tu krahasuar me situacionin përfundimtar të punimeve*) dhe volumeve të situacionuara nga sipërmarrësit, të miratuar nga autoriteti kontraktor, rezulton se në situacionet përfundimtare të restaurimeve janë situacionuar zëra dhe sasi punime të pa miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, më tepër se sasi të preventivit të miratuar (*preventivit bazë + përdorimin e fondit rezervë 5%, dhe shtesa 20% e punimeve sipas kontratës shtesë*) duke sjellë një përfitim të padrejtë për operatorin “**B**” sh.p.k. në vlerën 1,830,495 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të merren masat e duhura me qëllim shpërblimin e dëmit, për operatorin “**B**” sh.p.k. në vlerën **1,830,495** lekë pasi në situacionin përfundimtar të punimeve për “*Punime rehabilituese Pallatit të Kongreseve*”, janë situacionuar punime të pa miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve më tepër se sasi të preventivit të miratuar (*preventivit bazë+ dhe shtesa 20% e punimeve sipas kontratës shtesë*) duke sjellë një përfitim të padrejtë për operatorin.

Menjëherë

2-Për tejkalim të afateve të realizimit të kontratës me nr. 3548, datë 6.8.201 për “*Punime rehabilituese Pallatit të Kongreseve*” nga operatori “**B**” sh.p.k. janë llogaritur dëme të likujdueshme në vlerën 506,504 lekë me t.v.sh. e cila duhet të arkëtohet (*Trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për operatorin “**B**” sh.p.k. për vlerën **506,504** lekë e cila rezulton nga llogaritja e dëmeve të likujdueshme

për tejkalim të afateve të realizimit të kontratës me nr. 3548, datë 6.8.201 për “*Punime rehabilituese Pallatit të Kongreseve*” nga operatori “*B*” sh.p.k dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

3-Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të restaurimit të administruara në dosjet teknike rezulton se në situacionet mujore janë paguar zëra punimesh të parealizuara, të parashikuara në kontratë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve shoqërinë “*Archispace studio*” sh.p.k. dhe z. Z.L.. Si rrjedhojë janë likuiduar situacione për punë të pakryera të përfituara nga subjektet “*BE-IS*” sh.p.k në objektin “*Punime rehabilituese Pallati i Kongreseve*”, në vlerën 598,418 lekë me t.v.sh dhe “*AK*” sh.p.k në objektin “*Rikonstruksion i Muzeut Historik Kombëtar*”, në vlerën 313,938 lekë me t.v.sh. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, në vlerën **912,356** lekë si më poshtë:

1-Për operatori “*B*” sh.p.k në vlerën **598,418** lekë me t.v.sh. për punë rehabilituese të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “*Punime rehabilituese Pallati i Kongreseve*”, të zhvilluar në vitin 2014.

2- Për operatori “*AK*” sh.p.k. në vlerën **313,938** lekë me t.v.sh. për punë restauruese të pa kryera dhe të përfituara padrejtësisht në objektin “*Rikonstruksion i Muzeut Historik Kombëtar*”, të zhvilluar në vitin 2014.

Menjëherë

B2- Për projektet në kulturë e trashëgimi:

4-Nga auditimi u konstatua se me memon nr. 354, datë 27.01.2015 “*Për dhurimin e kopjeve të botimit të veprës së plotë të De Radës stafit të MK*”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse ka konfirmuar shpërndarjen për vitin 2015 të 65 seteve ose 390 veprave, të mara në dorëzim sipas listës së punonjësve. Gjithashtu janë bërë dalje nga grupi që kryente inventarizimin disa subjekteve pa urdhër gjithsej 75 sete ose 450 vepra. Nga verifikimi i gjendjes faktike në magazinë të disa tituj librash u konstatuan diferenca në gjendjen e veprave të De Radës në ambientet e magazinës me diferencë për sasinë prej 540 vepra, në vlerë 178,200 lekë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet nga z. G.Ç. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.20214 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për z. **G Ç** në vlerën **178,200** lekë pasi nga auditimi u konstatua se në ambientet e magazinës gjendja e veprave të De Radës është me diferencë për sasinë prej 540 vepra në vlerë 178,200 lekë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

5-Sipas faturës tatimore nr. 20, datë 15.12.2014 është kryer pagesa në shumën 6,000 euro me transfertë bankare në llogarinë bankare të URI-t sipas pasqyrës financiare të paraqitur nga konsulenti në të cilin raportohen shpenzimet e periudhës të cilat justifikojnë vetëm shpenzimet për udhëtime e dieta në shumën 2,415 euro kurse pjesa tjetër prej 3,585 euro nuk ka asnjë dokument që justifikon ndonjë veprimtari të kryer sipas detyrave të parashikuara në kontratë, referuar kushteve speciale të kontratës neni 27 “Verifikimi i shpenzimeve nga Autoriteti Kontraktor”, nenit 28, 28, 2 ku si person përgjegjës për verifikimin e shpenzimeve është ngarkuar z. Shpëtim Shehu, dhe nenit 29; 29; 1 paragrafi i parë: “shumat aktuale të pagueshme pas pagesës së parë të parafinancimit do të ndryshojë. Ata do të bazohen në faturën e Kontraktuesit e shoqëruar me një raport të përkohshëm të progresit dhe një raport të verifikimit të shpenzimeve dhe janë subjekt i miratimit të raporteve në përputhje me Nenin 27 të Kushteve të Përgjithshme” (Trajtuar më hollësisht në faqet 50-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për subjektin “” (URI) në vlerën **3,585 Euro** pasi sipas faturës tatimore nr. 20, datë 15.12.2014 kjo vlerë është pa asnjë dokument që justifikon ndonjë veprimtari të kryer sipas detyrave të parashikuara në kontratë, referuar kushteve speciale të kontratës neni 27 “Verifikimi i shpenzimeve nga Autoriteti Kontraktor”, nenit 28, 28,29; 1 paragrafi i parë: “shumat aktuale të pagueshme pas pagesës së parë të parafinancimit do të ndryshojë. Ata do të bazohen në faturën e Kontraktuesit e shoqëruar me një raport të përkohshëm të progresit dhe një raport të verifikimit të shpenzimeve dhe janë subjekt i miratimit të raporteve në përputhje me Nenin 27 të Kushteve të Përgjithshme”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

6-Likuidimi i “CE” në shumën 264,590 lekë është kryer sipas faturës tatimore datë 18.06.2014, shoqëruar me situacionin e shërbimeve firmosura vetëm nga kompania pa raport monitorimi nga ana e MK për kryerjen e shërbimeve në cilësi, për çdo zë të eventit dhe bashkëlidhur praktikës nuk ka asnjë dokumentacion i cili të vërtetojë shpenzimet, shërbimet e kryera për 143,590 lekë vlerë e përfituar padrejtësisht (Trajtuar më hollësisht në faqet 50-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administ ative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për subjektin “CE” në shumën **143,590 lekë** për sa likuiduar sipas faturës tatimore datë 18.06.2014, shoqëruar me situacionin e shërbimeve firmosura vetëm nga kompania pa raport monitorimi nga ana e MK për kryerjen e shërbimeve në cilësi, për çdo zë të eventit dhe bashkëlidhur praktikës nuk ka asnjë dokumentacion i cili të vërtetojë shpenzimet, shërbimet e kryera për tre zërat e mësipërme, vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

7-Me Urdhër Shpenzimin nr. 405, datë 15.8.2014, është likuiduar organizata “Doku Fest” në vlerën 742,000 lekë (*paradhënie*) në kundërshtim me nenin 5, pika 5 të kontratës nr. 2910, datë 26.6.2014 të lidhur me këtë subjekt, nuk është përmbushur detyrimi që “*brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të zhvillimit të veprimtarisë duhet të paraqesë të dokumentuar situacionin e realizimit të fondit të financiar sipas kontratës dhe faturën përkatëse për të gjithë zërat e financuara nga “Financuesi” duhet të justifikohen me dokumentet e mëposhtëm....*” për pasojë paradhënia nuk është justifikuar me dokumentacionin përkatës në kundërshtim me nenin 5, pika 5 të kontratës si dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë e sektorit publik dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin (Trajtuar më hollësisht në faqet 32-50 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për organizatën “**DF**” në vlerën **742,000** lekë pasi paradhënia nuk është justifikuar me dokumentacionin përkatës në kundërshtim me kontratën nr. 2910, datë 26.6.2014 nenin 5, pika 5 të lidhur me këtë subjekt, që “*brenda 20 ditëve nga përfundimi i afatit të zhvillimit të veprimtarisë duhet të paraqesë të dokumentuar situacionin e realizimit të fondit të financiar sipas kontratës dhe faturën përkatëse për të gjithë zërat e financuara nga “Financuesi” duhet të justifikohen me dokumentet e mëposhtëm....*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë e sektorit publik*”, vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik për buxhetin dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

8-Me Urdhër Shpenzimin nr. 871, datë 23.12.2014, është kryer pagesa prej 270,000 lekë, honorar për jurinë në emër të B.Ç. dhe R.D., në një kohë që në procesverbalin datë 5.12.2014 të jurisë rezulton që këta anëtarë nuk kanë nënshkruar këtë akt për të vërtetuar pjesëmarrjen në juri (*trajtuar më hollësisht në faqet 32-50 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për znj. **B. Ç.** në vlerën **135,000** lekë dhe z. **R.D.** në vlerën **135,000** lekë sa përfituar padrejtësisht honorare si anëtarë jurie në një kohë që në procesverbalin datë 5.12.2014 të jurisë rezulton që këta anëtarë nuk kanë nënshkruar këtë akt për të vërtetuar pjesëmarrjen në juri, vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik për buxhetin dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

B3. Të tjera:

9-Në tenderat e zhvilluar me objekt “*Blerje karburant*”, nga llogaritja e furnizimit të likuiduar për subjektin, “*K*” *sh.a.* rezulton se nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratës për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratën doganore SAD, janë likuiduar 139,036 lekë pagesa më tepër përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*” Kreu VIII, pika 2/c (*Trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për operatorin “K” sh.a. për vlerën **139,036** lekë, e cila rezulton nga mos respektimi i çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturën, bazuar në çmimit referuar bursës REUTERS botuar në buletin e APP, deklaratës doganore SAD, për kontratat “blerje karburant”, përfituar në kundërshtim me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII, pika 2/c dhe duhet të arkëtohet

Menjëherë

10-Sipas fletës së inventarit dt. 04.02.2014 të mbajtur nga komisioni K.B., E.B., B.P. dhe firmosur nga personat përgjegjës R.M., A.D. për materialet në ngarkim, vlera e setit të kolltukëve (për të cilët është planifikuar shpenzimi i riparimit) prej 720,000 lekë nuk janë gjendje në ambientet e zyrës së ministrit dhe konsiderohen mungesë inventari (Trajtuar më hollësisht në faqet 30-32 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit për **R.M.**, në vlerën **360,000** lekë dhe **A.D.** në vlerën **360,000** lekë për materialet në ngarkim, vlera e setit të kolltukëve prej 720,000 lekë të cilët nuk janë gjendje në ambientet e zyrës së ministrit dhe konsiderohen mungesë inventari.

Menjëherë

11-Janë harxhuar për lëvizjen e punonjësve të administratës 890 litra karburant në vlerën 161,123 lekë të pa justifikuar me km të përshkruara në fletë udhëtimet e pa firmosura nga personat udhëtues për çdo muaj e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet (Trajtuar më hollësisht në faqet 29-30 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër ju është rekomanduar:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, për znj. **O. C.** në vlerën **80,561** lekë dhe z. **L. Gj.** në vlerën **80,561** lekë sa harxhuar karburant të pa justifikuar me km të përshkruara në fletë udhëtimet e pa firmosura nga personat udhëtues për çdo muaj, vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohet.

Menjëherë

C. MBI ZBATIMI ME EFICENSË, EFIKASITET DHE EKONOMICITET I FONDEVE PUBLIKE.

1-Në tenderin me objekt *“Realizimi i dekorit të qytetit të Tiranës në kuadër të vizitës së Papa Françeskut”* me vlerën 55,829,720 lekë operatori “E” sh.p.k. duhej skualifikuar nga KVO pasi nuk plotësonte kërkesat sipas DST:

-Për sa i përket përvojës së mëparshme, autoriteti kontraktor ka paraqitur tre kontrata punimesh të cilat nuk plotësojnë këtë kërkesë pasi vlera që duhej të plotësonte për një objekt të vetëm duhej të ishte 14,550,432 lekë .

-Për kërkesën sipas DST *“Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet (2011, 2012, 2013) duhet të ketë një vlerë jo më pak se fondi limit i prokurimit”* operatori “E” sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin tatimor ku ka paraqitur vetëm xhiron vjetore për vitin 2014 e cila është 9,527,465 lekë nga 29,100,864 lekë që duhej të ishte.

-Për kërkesën sipas DST *“Të ketë të punësuar minimalisht 13 punëtorë të siguruar për periudhën janar shtator 2014”* operatori “E” sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin nr. 42450/1, dt. 30.6.2014 për periudhën janar-maj 2014 mesatarisht 3 punonjës. Për sa më lart mban përgjegjësi KVO, L. M. Kryetar, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, M. S. anëtar, J. G. anëtar, E. D. anëtar, N. B. anëtar, Përgjegjës sektori buxhet&statistikës. Kualifikimi i mësipërm ka sjellë mos përdorimin e fondeve me *efiçensë, efikasitet dhe ekonomikitet me efekte financiare në fondet publike (trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).*

2-Nga auditimi i zbatimit të *“Rikonstruksion i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë”*, *“Punime rehabilituese Pallatit të Kongreseve”*, *“Rikonstruksioni i Fasadave të Objekteve në sheshin “Nënë Tereza”*, krahasimi i zërave të punimeve të miratuara sipas procesverbaleve të datës 01.11.2014 dhe dt. 20.9.2014 me tabelat e rakordancave përfundimtare (nuk ka të hartuar një preventiv përfundimtar me të gjitha ndryshimet për tu krahasuar me situacionin përfundimtar të punimeve) dhe volumeve të situacionuara nga sipërmarrësit përkatësisht “AK sh.p.k., “B” sh.p.k., “F” sh.p.k. të miratuar nga autoriteti kontraktor znj. E.K. dhe mbikëqyrësi i punimeve z. Z. L. rezulton se në situacionet përfundimtare të restaurimeve janë situacionuar zëra dhe sasi punime të pa miratuara nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, (preventivit bazë + përdorimin e fondit rezervë 5%, dhe shtesa 20% e punimeve sipas kontratës shtesë) në vlerën 16,030,964 duke sjellë mos përdorimin e fondeve me *efiçensë, efikasitet dhe ekonomikitet me efekte financiare në fondet publike (trajtuar më hollësisht në faqet 65-109 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).*

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* neni 15, germa c, nenin 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 *“Për nëpunësin civil”*, i është rekomanduarmë Ministrin të Kulturës, për shkeljet e konstatuara në financimin e projekteve në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, të japë masa disiplinore:

“vërejtje” deri në “largim nga shërbimi civil”, duke gjykuar në bazë të përgjegjësisë rast mbas rasti, për punonjësit si më poshtë:

1-Znj. E.K., në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm për shkelje të konstatuara në lidhjen e kontratave për përfituesit e financimit të projekteve nga Ministria e Kulturës dhe konkretisht në projektet:

“Festivali i Dritave” ku konstatohet se:

-Me Urdhrin nr. 338, datë 17.11.2014 është miratuar shpallja e fituesit bashkimi i operatorëve “A& S”, shpallje e cila bie në kundërshtim me VKM nr. 709, datë 24.10.2012 kreu III, pika 3, sipas të cilit “Komisioni ka për detyrë vlerësimin e ofertës më të mirë të paraqitur...”. Në urdhrin e tij Sekretari i Përgjithshëm shprehet qartë se “KVO nuk ka dalë në një vendimmarrje lidhur me këtë procedurë” dhe megjithatë vendos të shpallë fitues bashkimin e operatorëve “A& S”, ndërkohë që KVO-ja nuk ka bërë klasifikimin e BOE. Ky veprim ka sjellë si pasojë tejkallim të kompetencave të njohura me VKM nr. 709, datë 24.10.2012 kreu III, pika 3.

-Amendimi i kontratës nr.5409/, datë 20.11.2014 për ndryshimin e nenit 1 të kontratës bazë është bërë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 321, datë 11.11.2014, pika 5, pasi me këtë urdhrë janë deleguar vetëm kompetencat për ndjekjen e fazave të zhvillimit të procedurës për përzgjedhjen e operatorit për realizimin e projektit dhe jo për ndryshimin e kushteve të kontratës, veprim i cili bie në kundërshtim dhe me nenin 10 të kontratës nr. 5409, datë 19.11.2014, sipas të cilës “kontrata mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin reciprok të palëve”. Në respekt të këtij detyrimi ligjor ndryshimi i kushteve të kontratës është tagër i ministrit dhe jo i Sekretarit të Përgjithshëm.

-**Bunk-Art** (BUNKERI) ku konstatohet se:

Me Urdhrin nr. 309, datë 30.10.2014 të ministrit, urdhërohet financimi i projektit “BUNKERI” që do të realizohet nga QSSL në vlerën **11,985,000** lekë, autorizohet znj. E.K., Sekretare e Përgjithshme për nënshkrimin e kontratës me z. E.G., Drejtor Ekzekutiv i QSSL me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit nr. 5208, datë 11.11.2014. Lidhja e kontratës, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, neni 27/1, i ndryshuar dhe VKM nr. 709, datë 24.10.2012 kreu III, pika 3, 4 dhe 5, pasi subjekti përfitues nuk është përzgjedhur nga komisioni i ngritur për vlerësimin e cilësisë artistike e ekonomike dhe Kolegjiumi, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi znj. E.K., Sekretare e Përgjithshme (*Trajtuar më hollësisht në faqet 32-50 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

-Procedurat dhe nënshkrimi i kontratës me Njësinë e Menaxhimit të Projektit “*Instituti e Kërkimeve Urbane*” për llogari të projektit “ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” nominimi dhe ftesa e pjesëmarrësve në negociim janë kryer në shkelje me rregulloret e fondeve IPA si dhe marrëveshjen e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar, duke i dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë “*Instituti të Kërkimeve Urbane*” menaxhimin e a fondeve të cilat Ministria duhet ti menaxhonte me efektivitet e transparencë.

-Në pagesat e kryera për llogari të subjektit “URI” është reflektuar mbajtja dhe derdhja e tatimit në burim prej 10% të shumës së paguar referuar kontratave të lidhura por në asnjë rast nuk paraqitet nëse këta ekspert janë të regjistruar dhe derdhen sigurime shoqërore e shëndetësore e shoqëruar me kopje të listë pagesës sipas deklarimit online pranë tatim taksave, formularët e deklarimit (FDP) për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin në burim për të ardhurat nga punësimi, sipas ligjit nr. 7703, dt. 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 10383, dt. 24.02.2011 “*Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar. *Për sa më lart mban përgjegjësi znj. E.K. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MK, Shpëtim Shehu me detyrë Drejtor i Financës.*

-U konstatua se në Kushtet Speciale të Kontratës sipas nenit 30 “*Garancia Financiare*” është përjashtuar garancia e parafinancimit nga “URI” në kundërshtim kjo me parashikimin e bërë në nenin 30 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës e cila nuk e përjashton garancinë financiare, por e parashikon atë, në të njëjtën shumë me atë të parafinancimit, në këtë rast në shumën 16,780 euro. *Për sa më lart mban përgjegjësi znj. E.K. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MK, Sh.Sh. me detyrë Drejtor i Financës (trajtuar më hollësisht në faqet 50-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).*

2. znj. L. B. me detyrë ish-Shef i Kabinetit,

pasi:

-Referuar kontratës së shërbimit nr. 2281, datë 19.5.2014, neni 7/3, “sipërmarrësi-(Beyond Entropy Ltd)” ka detyrimin t’i dorëzojë “porositësit” 200 kopje të katalogut zyrtar të gjitha materialeve të tjera publicitare, detyrim i cili nuk është përmbushur nga “sipërmarrësi” pasi janë dorëzuar 10 kopje të këtij katalogu. Nga korrespondenca elektronike rezulton se me datë 13.11.2014, nga znj. L. B., me detyrë ish Shefe e Kabineti, është kërkuar nga BE (sipërmarrësi) vetëm 10 kopje të katalogut duke u shprehur se ”pjesën tjetër mund ta shpërndani”, fakt ky që përsëritet si kërkesë dhe me e-mail e datës 01.12.2014. Ndryshimi në sasi i parashikuar në nenin 7 të kontratës, nuk është bërë me miratimin e dy palëve sipas kërkesave të nenit 14/4 të kontratës së sipërme, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi znj. L. B. me detyrë ish Shef i Kabinetit (Trajtuar më hollësisht në faqet 32-50 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

3-N. R., 4-B. K., 5-Zh. H.i, 6-L. M., 7-J. G., 8-O. C., 9-G. Ç., 10-M. B., 11-E. B., 12-Sh. Sh., 13-A. A.,

Pasi nga auditimi rezultoi:

1-Personat në cilësinë e grupin e punës të projektit “ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” trajtuar si më poshtë;

-Nga Ministria të Kulturës për llogari të projektit “ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” është kërkuar rialokim të fondeve në kategori të ndryshme nga të cilat është shtuar kryesisht zëri i ekspertit të jashtëm në shumën 83 900 euro pra më shumë se gjysma e fondeve shkojnë për ekspertin e jashtëm i cili kontraktohet më vonë për të menaxhuar 83 mijë euro të mbetura për aktivitet e tjera të komponentëve të parashikuar, të cilat listohen të shpenzuar për një ekspozitë, një konference në ambientet e MK si dhe shpenzime dieta, duke shkelur parimet e eficences, efektivitetit dhe ekonomicitetit, parimet themelore të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, stimulimi e pjesëmarrësve dhe barazinë e kandidatëve për përdorimin efektiv të fondeve. Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga B. K., N. R., L.M., R. Xh., H.D., M. B. dhe E. B. dhe Sekretari i Përgjithshëm znj. E. K..

-Procedurat e ndjekura nga Ministria e Kulturës dhe nënshkrimi i kontratës me Njësinë e Menaxhimit të Projektit “Instituti e Kërkimeve Urbane” për llogari të projektit ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” nominimi dhe ftesa e tre pjesëmarrësve në negociim të cilët nga dokumentacioni i tenderimit, rezulton se kanë lidhje dhe bashkëpunim me njëri tjetrin me qëllim fitimin e kontratës nga “URI” duke shkelur në mënyrë të hapur e klienteliste rregulloret e fondeve IPA si dhe marrëveshjen e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar, Neni 28: “Përfituesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar apo kundërshtuar çdo praktikë aktive apo pasive korrupsioni në cilëndo fazë të procedurës tenderuese apo procedurës së dhënies së grantit ose gjatë zbatimit të kontratave korresponduese” duke e kthyer procesin në një proces abuziv me qëllim dhënien në mënyrë të drejtpërdrejtë “Instituti të Kërkimeve Urbane” menaxhimin e atyre pak fondeve të cilat Ministria duhet ti menaxhonte me efektivitet dhe transparencë në përputhje me aktivitetet e parashikuara nga programi për çdo kategori. Për sa më lart mban përgjegjësi Sekretari i Përgjithshëm znj. E.K. dhe grupi i punës i përbërë nga B. K., N. R., L.M., R. Xh., H.D., M. B. dhe E. B.

-Për argumentimin e fondit limit për ekspozitën “Coexistence - Atvision Equipment And Organization” nuk ka asnjë analizë çmimi me kostot e përfshira lidhur me këto çmime përshtatur cilësisë së kërkuar, nuk ka një ndarje midis studimit të tregut për pajisjet elektronike, elektrike dhe materialeve të tjera të nevojshme për ekspozitën, gjithashtu nuk ka

një ndarje midis punës që do të kryhet, mallit që do blihet si dhe instalimit të tyre. *Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i Punës Ledia Mirakaj, Risena Xhaja, Herida Duro, Mariana Braholli dhe Edlira Bitincka.*

-Nga URI nuk argumentohet se nga cila short-list janë përzgjedhur kompanitë që sugjeron, mbi çfarë kriteresh dhe eksperiencash është bërë përzgjedhja e tyre për konkurrim për ekspozitën “*Coexistence - Atvision Equipment And Organization*”, në kundërshtim kjo me nenin 121 të Rregullores zbatuese të fondeve IPA 718/2007 si dhe Seksionit 5.3.4 “*External expertise*” të manualit udhëzues të Programit IPA –Adriatik-PMC. *Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i Punës i përbërë nga L.M., R. Xh., H.D., M. B. dhe E. B.*

-Nuk ka asnjë gjurmë administrative se në çfarë rruge janë nisur ftesat për tre subjektet e nominuara për pjesëmarrje në tenderin për ekspozitën “*Coexistence - Atvision Equipment And Organization*”, të cilat ndodhen në dosjen me nr. 2851/1, datë 04.06.2014. *Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i Punës L.M., R. Xh., H.D., M. B. dhe E. B.*

-Përzgjedhja e kompanisë që do të merret me organizimin e eventit “*Cosmos Translation and Event*” sh.p.k. nuk argumentohet se nga cila short-list janë përzgjedhur kompanitë dhe mbi çfarë kriteresh dhe eksperiencash është bërë selektimi i tyre për të marrë pjesë në konkurrim, në kundërshtim kjo me nenin 121 të Rregullores zbatuese të fondeve IPA 718/2007 si dhe Seksionit 5.3.4 “*External expertise*” të manualit udhëzues të Programit IPA –Adriatik-PMC. *Për sa më lart mban përgjegjësi grupi i punës i përbërë nga B. K., N. R., L.M., R. Xh., H.D., M. B. dhe E. B (trajtuar më hollësisht në faqet 50-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).*

2-Personat në cilësinë e anëtarit në Komisionin e vlerësimit të ofertave të projektit “ARTVISION “Adriatic Live Art Channel”:

-Pasi nga auditimi u konstatua se KVO për zgjedhjen e njësisë së menaxhimit të ekspertit të jashtëm për llogari të projektit ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” ka kryer vlerësime jo në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit, duke favorizuar e klasifikuar si fitues subjekte që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara për shpalljen fitues të tyre, ku ndër të tjera grupi i punës nuk argumenton se nga cila short-list janë përzgjedhur OJF e ftuara dhe mbi çfarë kriteresh dhe eksperiencash është bërë selektimi i tyre për të marrë pjesë në konkurrim, në kundërshtim kjo me nenin 121 të Rregullores zbatuese të fondeve IPA 718/2007 si dhe Seksionit 5.3.4 “*External expertise*” të manualit udhëzues të Programit IPA –Adriatik-PMC. *Për sa më lart mban përgjegjësi Komisionit të vlerësimit të ofertave i përbërë nga: L.M., Sh. Sh., J.G. dhe A.A.*

-KVO në vlerësimin dhe lidhjen e kontratës me URI nuk ka respektuar termat e referencës si dhe dokumentet standarde të tenderit pika 2 “*Objective, purpose & Expected results dhe pika 4 Scope of the Work*” pasi: Subjekti i shpallur fitues është subjekt i cili në përvojë të tij ka kërkimin dhe zhvillim urban, ndërkohë që ARTVISION “Adriatic Live Art Channel” ka si objektiv të përgjithshëm ngritjen e sasisë dhe cilësisë së komunikimit ndër-kulturor midis popujve të ndryshëm të vendeve të Adriatikut me qëllim strategjik përdorimin tematik të komunikimit televiziv satelitor dhe për të aktivizuar një metodologji inovative të planifikimit si pjesë e politikave kulturore në nivel institucional, pra *janë në dy kahe të kundërt objektivit dhe detyrat e projektit me përvojat dhe aftësitë menaxhuese të subjektit të përzgjedhur*, referuar CV së paraqitur nga vetë URI e cila është kryesisht në fushën e furnizimit me ujë, kanalizimeve, menaxhimit e aseteve etj.. *Për sa më lart mban përgjegjësi Komisionit të vlerësimit të ofertave L.M., Sh. Sh., J.G. dhe A.A.*

-Nga auditimi mbi procedurat e përzgjedhjes së URI-t si Njësi e Menaxhimit të Projektit konstatohet se: Referuar pikës 6 të *Termave të Referencës* mbi kualifikimet e stafit dhe detyrat kërkohet për çdo kategori ose WP me eksperiencat përkatëse në projekte të të njëjtës natyrë dhe madhësi, Instituti i Kërkimeve Urbane ka të angazhuar për këtë projekt 7 ekspertë

nga të cilët “*Legal Ekspert*” sipas termave të referencës nuk është i parashikuar. Sipas përcaktimit në termat e referencës personi i cili do të mbulojë rolin e “*Operacional Project Manager*” duhet të ketë 10 vjet eksperience në menaxhimin e projekteve të njëjta në natyrë dhe madhësi, ndërkohë që personi i cilësuar në rolin e “*Project Manger*” nga URI në CV e tij paraqet një eksperiencë e cila shtrihet në vitet 2010-2014 në projekte të ndryshme dhe nuk specifikohet si “*Project Manager*” por cilësohet eksperiencia e tij në *marrëdhëniet me median*. Për sa më lart mban përgjegjësi Komisionit të vlerësimit të ofertave L.M., Sh. Sh., J.G. dhe A.A.

-Nga auditimi mbi procedurat e përzgjedhjes së URI-t, i dokumentacionit teknik të subjekteve konkurrues, u konstatua se të tre subjektet kanë bashkëpunuar me njëri tjetrin dhe kanë lidhje ligjore mes tyre, me qëllim fitimin e kësaj kontrate nga URI pasi në dokumentin “*Service tender submission form të subjektit Children’s Future and Development*” emri dhe adresa e entitetit pjesëmarrës paraqitet “*Urban Research Institute*” dhe në rubrikën e personit të kontaktit znj. B. Ç. përfaqësuese e subjektit “*Children’s future and development*”. Në dokumentet e subjektit “*AE*” në vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë për regjistrimin si person juridik datë 03.10.2012 nr. 760 prot. si dhe në aktin e themelimit të qendrës nënshkruar dhe noteruar datë 18.09.2012 cilësohet z. M.R. si një nga themeluesit e këtij subjekti ndërkohë që ky person është i kontraktuar dhe nominuar si “*Communication Manager sipas statement of exclusivity and availability*” nënshkruar me “*Urban Research Institute*” datë 10 maj 2014 me kohë të plotë. Për sa më lart mban përgjegjësi Komisionit të vlerësimit të ofertave L.M., Sh. Sh., J.G. dhe A.A.

-Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit teknik të subjekteve për tenderin “*Coexistence -Atvision Equipment And Organization*” u konstatua se KVO ka vepruar në kundërshtim me dokumentet standarte të tenderit dhe kriteret e kualifikimit duke kualifikuar subjekte që nuk kanë përmbushur kushtet, kriteret e specifikuar dhe kërkuara në tender duke shpallur fitues “*CA*” kur pasqyrat financiare e paraqitura prej tij për ushtrimin e mbyllur më 31.12.2013 janë më rezultat negativ, gjë që tregon se ky subjekt nuk ka kapacitet financiar për përfitimin e kontratës që po prokurohet dhe se nuk ka paraqitur asnjë dokument apo evidencë të dokumentuar se është i aftë nga ana teknike për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, në kundërshtim me Dokumentet Standarte, nënpika 6, “*documentary evidencë of the financial and ekonomic capacity as well as the technical and professional capacity acording to the selection criteria specified in the procurement notice(see further point 2.4.11 of the Practical Guide)*”. Për sa më lart mban përgjegjësi Komisionit të Vlerësimit të Ofertave L.M., Sh. Sh., J.G. dhe A.A.

-Në pagesat e kryera për llogari të subjektit “*URI*” është reflektuar mbajtja dhe derdhja e tatimit në burim prej 10% të shumës së paguar referuar kontratave të lidhura por në asnjë rast nuk paraqitet nëse këta ekspert janë të regjistruar dhe derdhen sigurime shoqërore e shëndetësore e shoqëruar me kopje të listë pagesës sipas deklarimit online pranë tatim taksave, formularët e deklarimit (FDP) për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimin në burim për të ardhurat nga punësimi, sipas ligjit nr. 7703, dt. 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar si dhe ligjit nr. 10383, dt. 24.02.2011 “*Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar. Për sa më lart mban përgjegjësi znj. E. K. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MK, Sh. Sh. me detyrë Drejtor i Financës.

-Sipas faturës tatimore nr. 20, datë 15.12.2014 është kryer pagesa në shumën 6,000 euro me transfertë bankare në llogarinë bankare të URI-t sipas pasqyrës financiare të paraqitur nga konsulenti në të cilin raportohen shpenzimet e periudhës të cilat justifikojnë vetëm shpenzimet për udhëtime e dieta në shumën 2,415 euro kurse pjesa tjetër prej 3,585 euro *nuk ka asnjë dokument që justifikon ndonjë veprimtari të kryer sipas detyrave të parashikuara në*

kontratë , referuar kushteve speciale të kontratës neni 27 “Verifikimi i shpenzimeve nga Autoriteti Kontraktor”, neni 28, 28, 2 ku si person përgjegjës për verifikimin e shpenzimeve është ngarkuar z. Shpëtim Shehu, dhe neni 29; 29; 1 paragrafi i parë: “shumat aktuale të pagueshme pas pagesës së parë të parafinancimit do të ndryshojë. Ata do të bazohen në faturën e Kontraktuesit e shoqëruar me një raport të përkohshëm të progresit dhe një raport të verifikimit të shpenzimeve dhe janë subjekt i miratimit të raporteve në përputhje me Nenin 27 të Kushteve të Përgjithshme”.

-U konstatua se në Kushtet Speciale të Kontratës sipas neni 30 “Garancia Financiare” është përjashtuar garancia e parafinancimit nga “URI” në kundërshtim kjo me parashikimin e bërë në neni 30 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës e cila nuk e përjashton garancinë financiare, por e parashikon atë, në të njëjtën shumë me atë të parafinancimit, në këtë rast në shumën 16,780 euro. Për sa më lart mban përgjegjësi znj. E.K. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i MK, Sh.Sh. me detyrë Drejtor i Financës (trajtuar më hollësisht në faqet 50-65 të Raportin Përfundimtar të Auditimit).

3-Personat në cilësinë e anëtarit të Kolegjiumit për projektin “Bunk-Art (BUNKERI), në procesin e përzgjedhjes së aplikantit kanë kryer veprime që bien ndesh me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, i ndryshuar, të trajtuara më poshtë:

-Me shkresën nr. 4875, datë 24.10.2014, Kolegjiumi i sugjeron ministrit që MK “të marrë dokumentacionin shtesë lidhur me statutin e subjektit QSSL dhe më pas të procedoj me lidhjen e kontratës së shërbimit me **subjektin e përzgjedhur** nga Komisioni Shtetëror dhe miratuar me VKM”. Shkresa e sipërme nuk ka atributet e një vendimi të marrë nga Kolegjiumi, në respekt të neni 9/2 Rregullores së Funkionimit të Kolegjiumit, miratuar me Urdhrin nr. 107, datë 12.5.2014 të ministrit, **pasi Kolegjiumi nuk ka zhvilluar procedurën e vlerësimit të projektit dhe nuk ka dalë me një vendim konkret për projektin e përzgjedhur**. Komisioni Shtetëror ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 16, datë 10.3.2014, bazuar në pikë 4 të tij, ka si detyrë kryesore “**hartimin e programeve, organizimin, drejtimin, bashkërendimin e punës..... e veprimtarive për përkujtimin e ngjarjeve më të rëndësishme**”. Komisioni nuk bën përzgjedhjen e subjekteve që mund të realizojnë projekte të ndryshme në lidhje me këto aktivitete, tagër i cili me ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 i ndryshuar i është njohur MK, por ka tagrin vetëm të hartimit të programeve për përkujtimin e ngjarjeve më të rëndësishme. Është detyrë e MK, sipas ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, i ndryshuar, neni 27/1, a dhe VKM nr. 709, datë 24.10.2012, **të vlerësojë projektpropozimin** e përcjellë nga ky Komision. Për rrjedhojë, Kolegjiumi nuk ka përmbushur detyrat e tij funksionale pasi nuk ka miratuar veprimtarinë artistike sipas kërkesave të neni 27/1, a të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, i ndryshuar si dhe atyre të përcaktuara me Rregulloren e Funkionimit të cituar më lart, për të cilin mbajnë përgjegjësi N.R, B.K., Zh.H., L.M., J.G., O.C., G.Ç.

4-Në tenderin me objekt “Realizimi i dekorit të qytetit të Tiranës në kuadër të vizitës së Papa Françeskut” operatori “EC” sh.p.k. duhej skualifikuar nga KVO pasi nuk plotësonte kërkesat sipas DST:

-Për sa i përket përvojës së mëparshme, autoriteti kontraktor ka paraqitur tre kontrata punimesh të cilat nuk plotësojnë këtë kërkesë pasi vlera që duhej të plotësonte për një objekt të vetëm duhej të ishte 14,550,432 lekë .

-Për kërkesën sipas DST “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet (2011, 2012, 2013) duhet të ketë një vlerë jo më pak se fondi limit i prokurimit” operatori “EC ka paraqitur vërtetimin tatimor ku ka paraqitur vetëm xhiron vjetore për vitin 2014 e cila është 9,527,465 lekë nga 29,100,864 lekë që duhej të ishte.

-Për kërkesën sipas DST “Të ketë të punësuar minimalisht 13 punëtorë të siguruar për periudhën janar shtator 2014” operatori “EC” sh.p.k. ka paraqitur vërtetimin nr. 42450/1, dt.

30.6.2014 për periudhën janar-maj 2014 mesatarisht 3 punonjës. Për sa më lart mban përgjegjësi KVO, L.M. Kryetar, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, M. S. anëtar, J. G. anëtar, E. D. anëtar, N. B. anëtar, Përgjegjës sektori buxhet&statistikës.

A. TË TJERA:

1-Nisur nga auditimi i realizuar në këtë mision, mbi zbatimin e procedurave dhe nënshkrimin të kontratës me Njësinë e Menaxhimit të Projektit “*Instituti e Kërkimeve Urbane*” për llogari të projektit “ARTVISION “Adriatic Live Art Channel”, nominimi dhe ftesa e pjesëmarrësve në negociim të cilat janë kryer në shkelje me rregulloret e fondeve IPA si dhe marrëveshjen e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar, duke i dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë “*Instituti të Kërkimeve Urbane*” menaxhimin e fondeve, në mënyrë që të plotësohen gjetjet dhe të mbulohen të gjitha fazat me risk të projektit, është rekomanduarmë që të zhvillohet një auditim i plotë, mbi rregullshmërinë e përdorimit të fondeve IPA nga Ministria e Kulturës.

2-Nisur nga letrat e shumta (*të cilat si letra anonime s`mund të verifikohen*), Ministri i Kulturës të shikojnë konfliktin e interesit tek drejtuesit më të lartë të ministrisë në miratimin e projekteve kulturore apo në veprimtari të tjera, në kundërshtim me statusin e tyre dhe ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”. Për sa më lart të informohet nga ana jonë edhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bexhet Zeqiri përgjegjës grupi, Miranda Haxhiu, Mariola Lleshi, Valentina Sulo, Valdet Berisha dhe Alush Zaçe, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT